

PASDARKA E VOGËL

Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Tiranë, 2002

Prifti: I bekuar është Perëndia ynë gjithnjë; tani e përherë e në jetë të jetëve.

Por nëse nuk ka prift. thuhet nga lexuesi:

Në emër të Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Lexuesi: Amin

Prifti: (ose Lexuesi) Lavdi më Ty, o Krisht Perëndi, shpresa jonë, lavdi më Ty.

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesari i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i Mirë, shpirtrat tanë.

Lexuesi: Amin.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, fali mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote, si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: (Nëse nuk ka prift nuk thuhet)

Se jotja është mbretëria, dhe fuqia, dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin.

Mëshiro, o Zot (12 herë).

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Mbretit,
Perëndisë tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Krishtit,
Mbretit, Perëndisë tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë vetë
Krishtit, Mbretit e Perëndisë tonë.

Psalmi 50

Përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të
madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta
shuaj e paudhësinë time.

Lamë krejt prej paudhësisë sime dhe pastromë
prej mëkatit tim.

Se unë e njoh paudhësinë time dhe mëkati im
është përpara meje kurdoherë.

Te ti vetëm mëkatova dhe të keqen e bëra
përpara teje, kështu që ti je i drejtë në fjalët e tua
dhe i kthjellët në gjykimin tënd.

Se ja tek u zura në paudhësi, dhe në mëkate më
lindi nëna ime.

Se ja tek deshe të vërtetën, të patreguarat dhe të
fshehtat e urtësisë sate m'i tregove.

Spërkatmë me hisop dhe do të pastrohem, lamë
dhe do të bëhem më i bardhë se dëbora.

Bëmë të dëgjoj gëzim e ngazëllim dhe do të më gëzohen eshtrat e dobësuara.

Ktheje fytyrën tënde nga mëkatet e mia dhe shuaji gjithë paudhësitë e mia:

Krijoi zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtëri frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Mos më hidh larg prej fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Jepma prapë ngazëllimin e shpëtimit tënd dhe forcomë me frymë sunduese.

Do t'u mësoj të paligjve udhët e tua dhe të pabesët do të kthehen tek ti.

Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim, gjuha ime do të lavdërojë me gëzim drejtësinë tënde.

O Zot, çel buzët e mia dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde.

Se po të kishe dashur therore do të kisha prurë, por ty s'të pëlqejnë therore me djegie të plotë.

Therore ndaj Perëndisë është shpirti i dërrmuar; zemrën e dërrmuar dhe të përrulur Perëndia nuk do ta përbuzë.

Bëji të mirë, o Zot, Sionit sipas mirëdashjes sate dhe le të ndërtohen muret e Jerusalemit.

Atëherë do të të pëlqejnë therore drejtësie, dhurata dhe therore me djegie të plotë.

Atëherë do të sjellin viça mbi altarin tënd.

Psalmi 69

O Perëndi, ndihmës sime vëri re, o Zot, shpejto të më ndihmosh.

U marroreshin e u turpëroreshin ata që shpirtin tim kërkojnë;

Shpatullat ktheshin me turp dhe u mbulofshin ata që të keqen time duan.

Mbrapsht u ktheshin menjëherë të turpëruar ata që më thonë: Të lumtë, të lumtë!

U ngazëllofshin e u dëfrefshin në ty të gjithë ata që të kërkojnë, o Perëndi, dhe ata që duan shpëtim prej teje, thënshin përgjithnjë: U madhëroftë Zoti!

Dhe unë jam i varfër e nevojtar; o Perëndi, ndihmomë. Ti je ndihmësi im dhe çlirimtari im, o Zot; mos u vono.

Psalmi 142

O Zot, dëgjo faljen time, vëri veshin lutjes sime sipas së vërtetës sate, dëgjomë sipas drejtësisë sate.

Dhe mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënd, se asnjë i gjallë nuk do të dalë i drejtë përpara teje.

Se armiku ma ndoqi shpirtin dhe ma rrëzoi jetën përdhe.

Më vuri në vende të errëta, si të vdekurit prej kohe, shpirti m'u trishtua dhe zemra m'u trondit.

Kujtova ditët e lashta, mendova gjithë veprat e tua, sillja ndër mend punët e duarve të tua.

I shtriva duart drejt teje; shpirti im ka etje për ty si toka e thatë.

Dëgjomë shpejt, o Zot, m'u zu fryma, mos e kthe mënjanë fytyrën tënde prej meje, që të mos bëhem si ata që zbritën në varr.

Bëmë që të dëgjoj përdëllimin tënd në mëngjes se tek ty shpresova.

Tregomë, o Zot, udhën ku duhet të eci, se tek ty e kam varur shpirtin.

Shpëtomë prej armiqve të mi, o Zot, se tek ti kërkova strehë.

Mësomë të bëj vullnetin tënd se ti je Perëndia im.

Fryma jote e mirë do të më udhëheqë në vend të drejtë, për emrin tënd, o Zot, gjallëromë.

Sipas drejtësisë sate nxirr shpirtin tim nga trishtimi, dhe sipas mëshirës sate shfarosi armiqtë e mi, dhe shkatërroi të gjithë ata që hidhërojnë shpirtin tim se unë jam shërbëtori yt.

Dhoksologjia

Lavdi Perëndisë në më të larta dhe mbi dhenë paqe dhe mbi njerëzit mirëdashje.

Të himnojmë, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, ty të falënderojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot Mbret, Perëndi qiellor, At i tërëfuqishëm. Zot Bir i vetëmlindur Jisu Krisht, edhe Shpirti i Shenjtë.

Zot Perëndi, qengj i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatën e botës; mëshirona, ti që ngre mëkatet e botës.

Prano lutjen tonë, ti që rri në të djathtë të Atit, edhe mëshirona.

Se ti je shenjt i vetëm, ti je Zot i vetëm, Jisu Krisht, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

Për çdo mbrëmje do të të bekoj, dhe do të lavdëroj emrin tënd për jetë e në jetë të jetës.

O Zot, u bërë streha jonë brez pas brezi, unë thashë: a Zot mëshiromë, shëro shpirtin tim se fajtova tek ti.

O Zot, tek ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se ti je Perëndia im.

Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do të shohim dritë.

Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin.

Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë natë pa ndonjë mëkat.

I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërve tanë, dhe emri yt është i himnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin.

Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar tek ti.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua.

I bekuar je, o Zot, bëmë të mençëm në porositë e tua.

I bekuar je, o i Shenjtë, ndriçomë me porositë e tua.

O Zot, mëshira jote është për jetë, mos i hiq sytë nga veprat e duarve të tua.

Ty të ka hije lavdërimi, ty të ka hije himni, ty të ka hije lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Simboli i Besimit

Besoj në një Perëndi, Atë të tërëfuqishëm, krijues të qiellit edhe të dheut dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave.

Dhe në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve. Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të qenët një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha.

Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri.

Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat,
dhe pësoi e u varros.

Dhe u ngjall të tretën ditë sipas shkrimeve.

Dhe u ngjit në qiejt dhe rri në të djathtë të Atit.

Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të
gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të
ketë mbarim.

Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, Jetëbërës, që
buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë
me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve.

Në një Kishë të shenjtë, katolike dhe apostolike.

Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve.

Pres ngjalljen e të vdekurve.

Dhe jetën e ardhshme të amëshuar. Amin.

Të meriton me të vërtetë të të lumturojmë, Ty
Hyjlindësen, gjithmonë të lumturën dhe të
përbikulluarën dhe Mëmën e Perëndisë tonë. Më
të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën
pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde
Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, Ty të
madhërojmë.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i
pavdekshëm, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e
përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, fali mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (*3 herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote, si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: Se jotja është mbretëria, dhe fuqia, dhe lavdia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin.

Pastaj thuhet tropari i shenjtit të ditës, ose troparet e mëposhtme:

O Perëndi i Etrëve tanë, Ti që je gjithmonë me ne, sipas butësisë sate, mos largo mëshirën tënde, por me lutjet e tyre drejto me paqe jetën tonë.

Kisha jote e stolitur si me porfir dhe vis, me gjakun e martirëve të tu në gjithë botën, të thërret me anën e tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoi dhembshuritë e tua popullit tënd, dhuroi paqe shtetit tënd dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Bashkë me shenjtoret prehi, o Krisht, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, atje ku nuk ka as dhembje, as hidhërim, as psherëtimë, por jetë të pambaruar.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin

O Zot, me ndërmjetimet e gjithë shenjtoreve dhe të Hyjlindëses, jepna paqen tënde dhe mëshirona si i vetëm zemërdhembshur.

Mëshiro, o Zot (*40 herë*).

O Krisht Perëndi, që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë në qiell e mbi dhe, Ti që je zemërgjerë, i shumëmëshirshëm i shumëdhembshur, që i do të drejtët dhe i përdëllen mëkatarët, që i fton të gjithë për shpëtim me premtimin e të mirave të pritme. Ti o Zot, prano lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetën tonë tek porositë e tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të këqijash dhe

vuajtjesh; mbrona me engjëjt e tu të shenjtë që, duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre, të arrijmë në bashkimin e besimit dhe në njohjen e lavdisë Sate të paafrueshme, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (*3herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhërojmë.

Beko, o Atë, në emër të Zotit.

Prifti: Perëndia na përdëlleftë dhe na bekoftë, shfaq të fytyrën e Tij mbi ne dhe na mëshiroftë.

Por nëse nuk ka prift, thuhet nga lexuesi:

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot (*12 herë*).

Dhe shpëtona, o Virgjëreshë e Tërëshenjtë.

Lutje Hyjlindëses së Tërëshenjtë
(Nga Pavli, murg i Manastirit të Evergjetit)

E papikëluar, e papërlyer, e pacënuar, e panjollshme, Virgjëreshë e pastër, Zonjë Nuse e Perëndisë, që bashkove Fjalën Perëndi me njerëzit me lindjen tënde të çuditshme dhe mbështete natyrën e hedhur të gjinisë sonë me qiellorët; e vetmja shpresë e të dëshpëruarve dhe ndihma e të luftuarve; përkrahja e gatshme e atyre që rendin tek ti dhe strehë e gjithë të krishterëve; mos të ardhte ndot nga unë mëkatari, i mallkuari, që prisha tërë veten time me mendime, fjalë dhe vepra të turpshme dhe që u bëra rob me dashje nga plogështia mendore e dëfrimeve të jetës; por si Nënë e Perëndisë njeridashës, me dashamirësi le të të vijë keq për mua mëkatarin dhe plangprishësin, dhe prit lutjen që të blatohet prej buzësh të ndotura; dhe lutju Birit tënd dhe mbretit e Zotit tonë, duke përdorur guximin tënd prej nëne që të ma hapë dhe mua zemrën njeridashëse të mirësisë së tij; dhe, duke mos vënë re fjalët e mia të panumërta, të më kthejë në pendim dhe të më bëjë punëtor të sprovuar të porosive te tij.

Dhe ji pranë meje gjithnjë, si mëshirëplotë, hirplotë dhe mirëdashëse; në këtë jetë mbrojtëse dhe

ndihmëse e nxehtë, duke thyer sulmet e kundërshtarëve dhe duke më udhëhequr drejt shpëtimit; dhe në kohë të ikjes sime, duke u kujdesur për shpirtin tim të mjerë dhe duke dëbuar larg faqet e errëta të demonëve të ligj; dhe në ditën e frikshme të gjyqit shpëtomë nga Ferri i amëshuar dhe tregomë trashëgimtar të lavdisë së patregueshme të Birit tënd dhe Perëndisë tonë; të Cilin e paça, o Zonja ime, Hyjlindëse e përmbishenjtë, me ndërmjetimin dhe përkrahjen tënde me hirin dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krishtit; të Cilit i përket çdo lavdi, nder e adhurim, bashkë me Atin e tij të pafillim dhe Shpirtin e tij të Tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutje Zotit tonë Jisu Krisht
(Nga Andiohu, murg i Pandhektit)

Dhe jepna, o Zot, neve që shkojmë për gjumë, prehje trupi dhe shpirti; dhe ruajna nga gjumi i errët i mëkatit dhe prej çdo epshi të errët të natës. Pusho hovet e pasioneve, shuaj shigjetat e zjarrta të të ligut që lëvizin kundër nesh dinakërisht; thyej kryengritjet e trupit tonë dhe vër në gjumë çdo mendim tokësor e lëndor. Dhe dhurona, o Perëndi,

mendje vigjëluese, mendim të urtë, zemër esëll, gjumë të lehtë dhe pa ndonjë fantazi satanike. Dhe zgjona në kohë të faljes, të mbështetur në porositë e tua e duke pasur në veten tonë kujtimin e pathyer të gjykimeve të tua. Falna lavdërimin tënd tërë natën, që të himnojmë, të bekojmë e të lavdëroj më emrin tënd të gjithënderuar e madhështor, të Atit e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

E përmbi lavdëruar, gjithmonëvirgjër, e bekuar Hyjlindëse, dërgoja faljen tonë Birit tënd dhe Perëndisë tonë dhe lypi që të shpëtojë me anën tënde shpirtrat tanë.

O At, shpresa ime. O Bir përikja ime. Shpirti i Shenjtë, mburoja ime. Trini e Shenjtë, lavdi më Ty.

Gjithë shpresën time e vë tek ti, o Nënë e Perëndisë; ruajmë nën mbrojtjen tënde.

Me ty gëzohet, o Hirplotë, gjithë krijesa tërësia e engjëjve, dhe gjinia e njerëzve: o tempull i shenjtëruar dhe parajsë shpirtërore, mburrja e virgjërisë; prej së cilës u trupëzua dhe u bë djalë Perëndia ynë që është para jetëve. Se mitrën tënde e bëri fron dhe barkun tënd më të gjerë se qiejt. Me ty gëzohet, o Hirplotë, gjithë krijesa; lavdi më ty.

Lutje Engjëllit ruajtës

O Engjëll i shenjtë, mbrojtës i shpirtit tim të mjerë dhe i jetës sime të vuajtur, mos më lër, mua mëkatarin, as mos u largo prej meje për ngathtësinë time, mos i lësho vend djallit të lig për të pushtuar e sunduar trupin tim të vdekshëm, mbamë nga dora ime e mjerë dhe e mpirë dhe drejtomë tek udha e shpëtimit. Po, o Engjëll i shpirtit dhe i trupit tim të mjerë, ndjemë për gjithçka me të cilat të kam hidhëruar gjatë gjithë ditëve të jetës sime, si dhe për ndonjë faj të bërë ditën e sotme, mbromë edhe këtë natë dhe ruajmë nga çdo ndikim i armikut, që të mos e zemëroj Perëndinë me ndonjë faj dhe ndërmjeto tek Zoti për mua të më forcojë me frikën e tij dhe të më tregojë shërbëtor të denjë të mirësisë së tij. Amin.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse,
Si përhirim që e shpëtove prej tmerreve,
Qyteti yt të përshkruan, o Virgjëreshë.
Po sikundër ke fuqi të paluftueshme,
Prej çfarëdo rreziku shpëtomë;
Se po të thërres:
Gëzohu, o Nuse e panusëruar!

Gëzohu, o hirplotë Hyjlindëse Virgjëreshë Mari, Zoti është me ty. E bekuar je ti ndër gratë dhe e bekuar është pema e barkut tënd, se linde Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.

Por nëse nuk ka prift, thuhet nga lexuesi:

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona.

kur ka ai vazhdon:

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (*3 herë*).

Beko, o Atë i shenjtë.

Prifti: Krishti Perëndia ynë i vërtetë me ndërmjetimet e Nënës së Tij të pacënuar dhe krejt të papërlyer, me fuqinë e Kryqit të nderuar dhe jetëbërës; me mbrojtjet e Fuqive të nderuara qiellore, të patrup; me lutjet e Profetit të nderuar e të lavdëruar, Pararendës e Pagëzor Joan; të apostujve të shenjtë, të lavdëruar e të dëgjuar; të Martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; të Etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës; të Hyjprindërve të shenjtë e të drejtë Joakim dhe Ana,

të shenjtit (*të ditës*) që lusim sot dhe të gjithë shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si Perëndi i mirë dhe njeridashës.

Lexuesi: Amin.

Pastaj prifti thotë këto urata si më poshtë dhe populli, përgjigjet çdo herë: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Le të lutemi për paqen e botës.

Për të krishterët shpresëtarë dhe orthodhoksë.

Për Kryepiskopin tonë (*aksh*) dhe gjithë vëllazërinë tonë më Krishtin.

Për etërit dhe vëllezërit tanë që mungojnë.

Për ata që na urrejnë dhe për ata që na duan.

Për ata që na ndihmojnë dhe na shërbejnë.

Për ata që na porositën ne të padenjët të lutemi për ta.

Për çlirimin e robërve.

Për ata që udhëtojnë mirë në det dhe në ajër.

Për ata që dergjen në sëmundje.

Le te lutemi dhe për pjellorinë e pemëve të dheut.

Dhe për gjithë etërit dhe vëllezërit tanë orthodhoksë që u prehën më parë, këtu e kudo.

Le të themi dhe për veten tonë: Mëshiro, o Zot. Mëshiro, o Zot. Mëshiro, o Zot.

Lexuesi: Me bukurinë e virgjërisë sate dhe me shkëlqimin e pastërtisë sate, Gavrieli u çudit, Hyjlindëse, dhe të thërriste: Ç'lavdërim të denjë të të thur unë ty? Dhe si të të quaj nuk di dhe po shtangem. Prandaj të thërres siç u urdhërova: Gëzohu, o Hirplotë!

Prifti: Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht, mëshirona dhe shpëtona.

Lexuesi: Amin.